



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
"STRATI" Sh.p.k.




Adresa: Rr."Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 5411

Nr. 5052 Prot.

Tiranë, më 31.10.2022

Drejtuar : Qëndrës Kombëtare të Biznesit



Për dijëni : Shoqëria "Euro Panel M.F" sh.p.k

Adresa: Tiranë. Bërxulll, Autostrada Tiranë - Durrës, Km 13, Godinë
Përballë Artgres

ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.a

Lënda : Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative

Në Tiranë, sot më datë 31.10.2022,

Unë **Kozeta Guri**, përmbaruese gjyqësore private pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, e pajisur me çertifikatë Nr. 83, datë Maj 2012, lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të Vendimit Nr. 5693, datë 22.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se në datë 07.10.2022, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e Vendimit Nr. 5693, datë 22.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë:

Kreditor : ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A. (ish Telekom Albania Sh.A.)

Debitor : Shoqëria "Euro Panel M.F" sh.p.k

Me Objekt : *Kthim shume*

Me Vendimin Nr. 5693, datë 22.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur:

"Pranimin e kërkesë-padisë.

Detyrimin e të paditurit Shoqëria "Europanel M.F" sh.p.k ti paguaj palës paditëse Shqëria "One Telecommunications Albania" sh.a. shumën prej 109.035 lekë, si detyrim që rrjedh nga kontrata e abonimit dt. 04.06.2013, 26.06.2012, 13.09.2011 dhe 08.04.2011.

NIPT: L21825003E

Çertifikatë për ushtrim veprimtarie Nr: 26, Nr. 98, Nr. 83, Nr. 106

I.N-5367-06-2012

Ky vendim është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.

Shpenzimet gjyqësore në shumën 3000 lekë për pagesën e taksës gjyqësore, për 3 copë dëftesë komunikimi në vlerën 150 lekë për çdo dëftesë komunikim, të pa paguar nga pala paditëse i ngarkohen palës së paditur, për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

Me shkresën Nr. 4749 Prot., datë 07.10.2022 debitorit i është komunikuar afati për ekzekutimin vullnetar.

Sa më sipër bazuar në nenin 527 e vijues të K.Pr.Civile, Ligjit Nr.26/2019, datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat” dhe Udhëzimit Nr. 385/7, datë 28.06.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat”

URDHËROJ:

- 1- Qendrën Kombëtare të Biznesit të vendosë masën e sekuestros konservative mbi aktivet e regjistruara pranë jush që zotëron pala debitore:
 - **Shoqëria “Euro Panel M.F” sh.p.k, me NIPT K92228015J**, për ekzekutimin e vendimit me Nr. 5693, datë 22.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 2- Këto aktive të qëndrojnë të bllokuara deri në një urdhër të dytë.
- 3- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.
- 5- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

Përmbarues Gjyqësor Privat



NIPT: L21825003E

Çertifikatë për ushtrim veprimtarie Nr: 26, Nr. 98, Nr. 83, Nr. 106
LN-5367-06-2012